

20222513670

**LIGJ PËR HUAMARRJE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT ME HUA
NGA BANKA EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM SIPAS
MARRËVESHJES SË HUAS PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT RAJONAL PËR
MBETJET E NGURTA**

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut hyn në borxh te Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim nëpërmjet huas në vlerë prej 55.000.000 eurove, kushtuar financimit të Projektit rajonal për mbetjet e ngurta.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas së nenit 1 të këtij ligji përcaktohen me Marrëveshjen e huas që do të nënshkruhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Marrëveshjen e paragrafit 1 të këtij neni do ta nënshkruajë ministri i Financave.

Neni 3

Huaja e nenit 1 të këtij ligji ofrohet në dy këste. Kësti i parë është në vlerë prej 47.500.000 eurove, ndërsa Kësti i dytë është në vlerë prej 7.500.000 eurove.

Afati i pagimit të kështit të parë të huas është 15 vjet, me periudhë mospagimi të përfshirë prej katër vjetësh. Kësti i parë i huas do të paguhet në 22 këste gjysmëvjetore, më 20 prill dhe 20 tetor të çdo viti, duke filluar nga data e parë e përfundimit të vitit të katërt nga nënshkrimi i Marrëveshjes së huas.

Afati i pagimit të kështit të dytë të huas është 15 vjet, me periudhë mospagimi të përfshirë prej katër vjetësh. Kësti i dytë i huas do të paguhet në 22 këste gjysmëvjetore, më 20 prill dhe 20 tetor të çdo viti, duke filluar nga data e parë e përfundimit të vitit të katërt nga dita e disponueshmërisë për shfrytëzimin e kështit të dytë.

Norma e interesit është variabile dhe përbëhet nga EURIBORI gjashtëmujor i rritur për margjinë prej 1%.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim provizion të njëhershëm në vlerë prej 1% të vlerës së kështit të parë në afat prej shtatë ditëve nga dita e efektivitetit të kështesë.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim provizion të njëhershëm në vlerë prej 1% të vlerës së kështit të dytë në afat prej shtatë ditëve nga dita e disponueshmërisë për shfrytëzimin e kështit të dytë.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim provizion për mjetet e patërhequra në vlerë prej 0,5% të huas në nivel vjetor.

Për vlerën e mjeteve të patërhequra për kështin e parë, provizioni do të fillojë të llogaritet pas 60 ditëve nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes së huas së nenit 2 të këtij ligji.

Provizioni për mjetet e patërhequra për kështin e dytë do të fillojë të llogaritet pas 60 ditëve nga dita e disponueshmërisë për shfrytëzimin e kështit të dytë.

Neni 4

Projekti i nenit 1 të këtij ligji do të zbatohet nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe e Planifikimit Hapësinor.

Neni 5

Për realizimin e projektit të nenit 1 të këtij ligji, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe e Planifikimit Hapësinor do të nënshkruajë Marrëveshje projektuese me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Neni 6

Republika e Maqedonisë së Veriut do të shlyejë huan e nenit 1 të këtij ligji nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 7

Qarkullimi i të mirave dhe i shërbimeve, i kryer ndaj Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe të Planifikimit Hapësinor, të kushtuara për realizimin e Projektit rajonal për mbetjet e ngurta, financuar me Marrëveshjen e huas së nenit 2 të këtij ligji, lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar, me të drejtën e zbritjes (heqjes) së tatimit paraprak.

Qarkullimi i të mirave/mallrave, i kryer ndaj Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe të Planifikimit Hapësinor, të kushtuara për realizimin e Projektit rajonal për mbetjet e ngurta, financuar me Marrëveshjen e huas së nenit 2 të këtij ligji, lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar, nga detyrimet importuese dhe akciza për karburant si dhe nga tatimi i automjeteve motorike për mjetet automobilistike të udhëtimit.

Për qarkullimin e kryer ndaj Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe të Planifikimit Hapësinor, kushtuar për realizimin e Projektit rajonal për mbetjet e ngurta, financuar me Marrëveshjen e huas së nenit 2 të këtij ligji, ku i njëjti është debitor tatimor në përputhje me nenin 32 pika 4 dhe nenin 32-a të Ligjit të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, lirohet nga detyrimi i llogaritjes së pagesës së tatimit mbi vlerën e shtuar.

Qarkullimi i të mirave dhe i shërbime, i kryer ndaj realizuesit të përzgjedhur nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe e Planifikimit Hapësinor, i cili do t'i kryejë punët kontraktuese të kushtuara për realizimin e Projektit rajonal për mbetjet e ngurta, financuar me Marrëveshjen e huas së nenit 2 të këtij ligji, është i liruar nga tatimi mbi vlerën e shtuar me të drejtën e zbritjes së tatimit paraprak.

Importi i të mirave/mallrave, i kryer nga realizuesi i përzgjedhur nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe e Planifikimit Hapësinor, të kushtuara për Projektin rajonal për mbetjet e ngurta, financuar me Marrëveshjen e huas së nenit 2 të këtij ligji, lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar, nga detyrimet e importit dhe akciza për karburant dhe nga tatimi i automjeteve motorike për mjetet automobilistike të udhëtimit.

Për qarkullimin që është kryer ndaj realizuesit të përzgjedhur nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe e Planifikimit Hapësinor, i cili do të kryejë punimet kontraktuese, të kushtuara për realizimin e Projektit rajonal për mbetjet e ngurta, financuar me Marrëveshjen e huas së nenit 2 të këtij ligji, për të cilin është debitor tatimor në përputhje me nenin 32 pika 4 dhe nenin 32-a të Ligjit të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, lirohet nga detyrimi për llogaritjen dhe pagesën e tatimit mbi vlerën e shtuar.

Personi i tatueshëm që kryen qarkullim për të cilin është i liruar nga tatimi mbi vlerën e shtuar në përputhje me paragrafët 1, 3, 4 dhe 6 të këtij neni, detyrimisht, përveç emrit të pranuesit të të mirave ose të shfrytëzuesit të shërbimit, në faturë do të shënojë emrin e projektit dhe emrin e Marrëveshjes së huas së nenit 2 të këtij ligji.

Realizuesi i përzgjedhur, gjatë importit të të mirave/mallrave të liruara në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, organit doganor kompetent duhet t'i dorëzojë kopje të Marrëveshjes së huas së nenit 2 të këtij ligji, vërtetim nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe e Planifikimit Hapësinor që, realizuesi i përzgjedhur është zgjedhur për të kryer punimet kontraktuese në

Projektin rajonal për mbetjet e ngurta dhe deklaratë se të mirat/mallrat e importuara janë të kushtuara për realizimin e Projektit rajonal për mbetjet e ngurta, financuar me Marrëveshjen e huas huas së nenit 2 të këtij ligj.

Qarkullimi i të mirave dhe i shërbimeve të paragrafëve 4 dhe 6 të këtij neni, si dhe importi i të mirave/mallrave të paragrafit 5 të këtij neni, nuk mund ta tejkalojë vlerën e marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe të Planifikimit Hapësinor dhe realizuesit të përzgjedhur, për punët kontraktuese të kushtuara për realizimin e Projektit rajonal për mbetjet e ngurta, financuar me Marrëveshjen e huas së nenit 2 të këtij ligj.

Neni 8

Për realizimin e lirimit sipas nenit 7, paragrafi 2 dhe 5 të këtij ligji, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe e Planifikimit Hapësinor, përkatësisht realizuesi i përzgjedhur, dorëzon kërkesë në Ministrinë e Financave – Drejtorinë e Doganave.

Forma dhe përmbajtja e kërkesës së paragrafit 1 të këtij neni dhe dokumentacioni përkatës që duhet t'i bashkëngjitet kërkesës, përcaktohen nga ministri i Financave.

Neni 9

Të mirat/mallrat që kanë qenë të liruara nga pagesa e detyrimeve importuese në bazë të nenit 7 paragrafi 2 dhe 5 të këtij ligji, në afat prej tre viteve nga dita e importit, nuk mund të tjetërsohen, t'i jepen në shfrytëzim dikujt tjetër, të huazohen ose ndryshe të shfrytëzohen për qëllime të tjera, dhe jo për ato që janë liruara nga pagesa e detyrimeve importuese, para se të jenë paguar detyrimet importuese. Këto nuk guxojnë të jepen si peng, të jepen me qira ose të jepen si sigurim për detyrime tjera.

Nëse zotëruesi i së drejtës, para përfundimit të afatit sipas paragrafit 1 të këtij neni, të mirat/mallrat që kanë qenë të liruara nga pagesa e detyrimeve importuese në bazë të nenit 7 paragrafi 2 dhe 5 të këtij ligji, ka për qëllim t'i shfrytëzojë për qëllime të tjera, e jo për ato për të cilat janë liruara nga pagesa e detyrimeve importuese, parashtron kërkesë për pagesën e borxhit doganor te organi doganor.

Vlerën e borxhit doganor të paragrafit 2 të këtij neni, organi doganor e llogarit në bazë të elementeve të përcaktimit të detyrimeve që ishin të plotëfuqishme në momentin e parashtrimit të kërkesës për pagimin e borxhit doganor.

Në rast të mosrespektimit të dispozitave të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, vlera e borxhit doganor llogaritet në bazë të elementeve të përcaktimit të detyrimeve në momentin e pranimit të deklaratës doganore, në bazë të së cilës malli është liruara nga pagesa e detyrimeve importuese.

Neni 10

Akti nënligjor i parashikuar me këtë ligj do të miratohet në afat prej 60 ditëve nga hyrja në fuqi të këtij ligji.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".